




## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME DREJTORINË RAJONALE TË FORMIMIT PROFESIONAL NR. 4



Në kuadër të nismës “Çdo fëmijë rom në kopsht”, CRCA Shqipëri në vitin e dytë të implementimit të saj, ka punuar së tepërmi për fuqizimin e prindërve të komunitetit rom dhe jo vetëm, nëpërmjet ngritjes së “Klubeve të Prindërve” pranë çdo kopshti/shkolle të Tiranës.

Një prej tematikave të trajtuara në trajnimet e zhvilluara prej stafit të CRCA-së me “Klubet e Prindërve” ka qenë edhe ajo e mundësisë së “Formimit Profesional” të tyre. Shumë prindër gjatë kësaj kohe janë njohur nëpërmjet specialistëve të DRFP. 4 mbi larmishmërinë e kurseve profesionale të ofruara prej institucionit në fjalë.

Puna për fuqizimin e prindërve nuk është ndalur thjesht me informimin e tyre, por CRCA Shqipëri ka shkuar me tej ku në bashkëpunim me DRFP. 4 dhe Zyrën e Punës Tiranë, përgjatë muajit Tetor ka mundur regjistrimin e 9 prindërve të komunitetit rom në një prej kurseve profesionale falas prane DRFP. 4.

Pas regjistrimit të prindërve në kurset e dëshiruara, shumë prej nënave që zgjedhën kursin e parukerisë me lehtësim të CRCA-së kryejnë praktikën dhe ofrojnë shërbim falas në kopshtet dhe shkollat e qytetit të Tiranës.

Falë kësaj pune frytdhënëse, Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik Nr.4 , **Z. Piro Jani** kërkoi që ky bashkëpunim i bukur midis dy institucioneve të vazhdonte më tej duke u formalizuar nëpërmjet nënshkrimit të një marrëveshjeje bashkëpunimi.

Si rrjedhojë e kësaj të fundit, tashmë prindërit e “Klubeve” me të cilat CRCA Shqipëri po punon, e kanë shumë herë më të thjeshtë për t’u regjistruar edhe në mungesë të ‘dokumentacionit’ apo mos përmbushjes së ‘kriterëve’ të vendosura për çdo kursant.

Në momentin e firmosjes së marrëveshjes mes dy institucioneve, pavarësisht se nuk ishte e shkruar në të, Z. Jani garantoj se prindërit që do të regjistrohen prej CRCA-së kanë mundësinë e përzgjedhjes së orarit më të përshtatshëm për ta.

Për më shumë informacion ju lutem kontaktoni: [info@crca.al](mailto:info@crca.al) ose në numrin: +355 4 2265741



## COOPERATION AGREEMENT WITH REGIONAL DIRECTORATE OF PROFESSIONAL TRAINING NO. 4

In the framework of the initiative "Every Roma Child in Kindergarten", CRCA Albania in the second year of its implementation, has extensively worked to strengthen the parents of the Roma community and not only, through the establishment of "Parents Club" at each kindergarten/school of Tirana.

One of the many discussed topics during the trainings conducted by the CRCA staff with the "Parents Club" has been the possibility of "Professional Training" for them. Many parents during this time were introduced, by specialists of RDPT No. 4, the diversity of professional courses offered by this institution.

During the month of October, the work to empower parents was not focused at only informing them, but CRCA Albania has gone further, where in co-operation with RDPT No. 4 and Labor Office of Tirana has enabled the registration of 9 Roma parents in a professional free course at RDPT No. 4.

After registering all parents in the desired courses, many of the mothers who chose hairdressing courses, with the facilitating process of CRCA, are now practicing and offering free service to schools and kindergartens of the city of Tirana.

Thanks to this productive work, director of Regional Directorate of Public Professional Training No.4, Mr. Piro Jani asked that this beautiful collaboration between the two institutions to continue further, formalizing through the signing of a cooperation agreement.

As a result of the above, members of the "Parents Club's" with whom CRCA Albania is working, already have it much more simple to enroll, even in the absence of 'documents' or not fulfilling the 'criteria' set for each cadet.

At the moment of signing the agreement between the two institutions, even though it was not written, Mr. Jani assured that the parents registered by CRCA Albania have the option of selecting the most appropriate schedule and time for them.

For more information please contact: [info@crca.al](mailto:info@crca.al) or +355 4 2265741.